

Aktivitetet kryesore:

- Zhvillohet trajnimi i NSPK-ve të DVP Vlorë.
- Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të NSPK-ve të komisarariatit të Kukësit dhe të Peqinit.
- Mbledhja e parë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Kavajë.
- Mblidhen Komisionet Vendore Përzgjedhëse të Skemës së Granteve për qarqet e Korçës, Vlorës dhe Lezhës.
- Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të sektorit të analizës strategjike të komisarariatit të Elbasanit dhe të Kukësit.

www.cp-project.al
info@cp-project.al

Zhvillohet trajnimi i NSPK-ve të DVP Vlorë.



Edhe gjatë muajit mars programi SCPA, në vazhdim të planit të punës, zhvilloi në Vlorë gjatë datave 26-29 mars 2019 trajnimin e NSPK-ve të DVP Vlorë të ndarë në 2 grupe prej 17 NSPK (nga komisarati i Vlorës dhe stacionet e policisë të Selenicës dhe Orikutit). Trajnimet kishin për qëllim rritjen e aftësive profesionale për policimin në komunitet.

Ekspertët e programit SCPA në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë trajtuan gjerësisht temat teorike të tilla si Policimi në Komunitet si filozofi, sistemi dhe elementet e PK etj.



Një hapësirë e konsiderueshme iu dedikua trajtimit në mënyrë praktike të rolit, detyrave dhe përgjegjësi të NSPK-ve, si dhe të parandalimit në rendin publik, veprimet pro-aktiv në vend të atij reagues, bashkëpunimit të brendshëm në zonat policore si dhe bashkëpunimit me qytetarët dhe aktorët e tjerë të komunitetit etj.

Pjesëmarrësit patën rastin të shkëmbejnë eksperiencat e tyre dhe i ballafaquan ato me përvojat ndërkombëtare dhe ato të rajonit.

Ata e vlerësuan angazhimin, si dhe metodologjinë e përdorur dhe shprehën dëshirën për të pasur trajnime të ngjashme në të ardhmen.

Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të NSPK-ve të komisarariatit të Kukësit dhe të Peqinit (të zonave urbane dhe të zonave rurale).

Gjatë muajit mars, ekspertët e Programit SCPA kanë vazhduar trajnimin në vendin e punës të NSPK-ve të komisarariatit të Kukësit dhe të Peqinit.

Trajnimi ka konsistuar në patrullime të përbashkëta (NSPK+ ekspertët e SCPA) në terren si në zonat urbane ashtu dhe në ato rurale, duke shqyrtuar rast pas rasti aktivitete të ndryshme si dhe duke ushtruar praktika të mira të trajtuara gjatë trajnimit të NSPK-ve apo dhe të përvojave të kolegëve brenda sektorit.

Ky trajnim do të vazhdojë dhe në muajt në vijim.

Nga ana tjetër, këto trajnime kanë shërbyer si burim i rëndësishëm të dhënash të cilat do të pasqyrohen gjerësisht në raportin përfundimtar mbi trajnimin e NSPK-ve i cili po përgatitet nga ekspertët e programit.



]

Mbledhja e parë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Kavajë.



Në datën 25 mars 2019, u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit Vendor për Sigurinë Publike në Kavajë.

Ky aktivitet u krye në kuadër të projektit "Mobilizimi i komunitetit të Bashkisë Kavajë për policimin në komunitet", zbatuar nga CSDC Durrës dhe financuar nga Programi SCPA.

Në këtë mbledhje morën pjesë përfaqësues nga institucionet lokale të Kavajës si Bashkia Kavajë, Këshilli Bashkiak, Komisariati i Policisë, përfaqësues nga komuniteti etj.

Aty u diskutua rregullorja e KVSP- së e cila më pas do kalojë për miratimin formal në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak të Kavajës.

Mblidhen Komisionet Vendore Përzgjedhëse të Skemës së Granteve për qarqet e Korçës, Vlorës dhe Lezhës.

Në kuadër të aktiviteteve të Planit të punës së Programit në lidhje me Skemën e Granteve, u mbajtën mbledhjet e Komisioneve Vendore Përzgjedhëse të Skemës së Granteve për qarqet e Korçës, Vlorës dhe Lezhës.

EMP në bashkëpunim me DVP-të e këtyre qarqeve punoi intensivisht me aktorët vendorë për formimin e këtyre komisioneve, realizoi shpërndarjen në kohë të aplikimeve për grante tek anëtarët e këtyre komisioneve dhe finalizoi brenda afateve përzgjedhjen e aplikantëve fitues për Grantet.

Gjate muajve në vijim, EMP do të punojë për parapërgatitjen e fituesve në mënyre që aktivitetet që ato kanë parashikuar ti përshtaten më mirë nevojave të policisë dhe komunitetit në qarqet përkatëse

Vazhdojnë trajnimet në vendin e punës të sektorit të analizës strategjike, monitorimit, planifikimit dhe vlerësimit të komisarimit të Elbasanit dhe të Kukësit.

Në vijim të trajnimeve të vazhdueshme të sektorit të ri të analizës strategjike, monitorimit, planifikimit dhe vlerësimit (AMPV), ekspertët e EMP-së, gjatë muajit mars, kanë vazhduar trajnimet në vendin e punës të specialisteve të këtij sektori për DVP-të e Elbasanit dhe Kukësit.

Ekspertët e SCPA-së kanë trajtuar Modulin 4 të planit të trajnimeve për këtë sektor, cili konsiston kryesisht në metodat e menaxhimit të riskut dhe përpunimin e raporteve dhe planeve të punës apo dokumenteve të ngjashme duke i kushtuar vëmendjeje dhe kësaj metode të rëndësishme për punën e policisë.

Vazhdojnë punimet për ndërtimin Zyrës së Shërbimit të Qytetarëve në komisaratin e Librazhdit.

Programi SCPA, në përputhje me planin e punës ka vazhduar punën për përmirësimin e infrastrukturës së Zyrave të Shërbimit të Qytetarëve të Komisarimit të Librazhdit me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjes së besimit në punën e policisë.

Krahas kësaj zyre, po ndërtohet dhe zyra e intervistimit të të miturve dhe të grave të dhunuara në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare.

Puna në këtë objekt ka filluar që në fillim të muajit shkurt dhe ritmet e punimeve janë në një nivel të kënaqshëm.

Me përfundimin e ZSHQ, Komisarati i Librazhdit do ketë një përmirësim të dukshëm në qasjen dhe shërbimin ndaj qytetarëve.

